

# ANALIZË E SISTEMIT TË DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT TË PASURISË SË GJYQTARËVE TË GJYKATAVE ADMINISTRATIVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

DHJETOR 2018

40 lekë 35.535.340 lekë 35.535.340 lekë  
7 lekë 47.868.967 lekë 47.868.967 lekë  
lekë 27.050.737 lekë 27.050.737 lekë  
kë 23.383.913 lekë 23.383.913 lekë  
s 92.037.826 lekë 92.037.826 lekë  
37.153.671 lekë 37.153.671 lekë  
2.127.435 lekë 2.127.435 lekë  
428.520 lekë 428.520 lekë  
7.377 lekë 7.377 lekë  
3.786 lekë 3.786 lekë  
49 lekë 49 lekë  
r lekë 37.483.786 lekë  
lekë 40.705.49 lekë  
ë 35.167.13 lekë  
ë 24.188.582 lekë  
51.944.805 lekë  
26.245.738 lekë  
7.540.283 lekë  
72.435 lekë  
1.101 lekë  
7.731 lekë  
40 lekë  
7 lekë  
lekë  
lekë







**ANALIZË E SISTEMIT TË DEKLARIMIT DHE  
KONTROLLIT TË PASURISË SË GJYQTARËVE  
TË GJYKATAVE ADMINISTRATIVE  
NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË**

**DHJETOR 2018**

**Publikuar nga:**

Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Investigative, Shqipëri  
Rruga:Nikolla Jorga, Nr. 8/8, Tiranë, Shqipëri  
<http://birn.eu.com/>

**Përgjegjës:**

Kristina Voko  
Besar Likmeta

**Grafika:**

Jurgena Tahiri

© Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Investigative, Shqipëri  
Tiranë, 2018

# Përmbajtja:

I.	Hyrje	7
	Qëllimi i këtij studimi	8
	Organizimi i Gjykatave Administrative në Republikën e Shqipërisë	10
II.	Metodologjia e studimit	12
	Kampionimi	12
	Hedhja e të dhënave në databazë	13
	Analizimi i të dhënave	16
	Kufizime të metodologjisë	17
III.	Gjetjet e studimit	18
	Interesat Private – Pasuria Bruto	20
	Ndryshimet në pasurinë bruto	21
	Nënkategoritë e interesave private	24
	Pasuria sipas institucionit	29
	Detyrimet	31
	Totali i Detyrimeve	31
	Detyrimet e pashlyera	33
	Raporti pasuri bruto/detyrime sipas institucioneve	34
	Pasuria neto	36
	Të ardhurat	36
	Totali i të ardhurave	37
	Burimi i të ardhurave	38
	Shpenzimet	40
	Të ardhurat neto	42
	Kontrolli aritmetik dhe logjik	43
IV.	Diskutime dhe rekomandime	48
	Aneksi I: Kodifikimi i kategorive dhe nënkategorive	50
	Aneksi II: Kursi i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë	51
	Aneksi III: Shpenzimet mesatare për familje sipas INSTAT	52



## I. Hyrje

Deklarimi i pasurisë konsiderohet një instrument i rëndësishëm në zbulimin e korrupsionit, pasurimit të paligjshëm apo konfliktin e interesit të zyrtarëve publikë. Sipas Bankës Botërore, të paktën 150 vende, përfshirë dhe Shqipërinë kanë ndërtuar sisteme për deklarimin dhe kontrollin e pasurisë së zyrtarëve publikë. Shumë vende i bëjnë deklaratat e pasurisë së zyrtarëve të aksesueshme online, ndërsa në Shqipëri deklarimi i interesave private mund të qaset vetëm me anë të një kërkesë për të drejtë informimi në Inspektoriatin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, ILDKPKI.

Qasja direkte e publikut ndaj deklaratave të pasurisë së zyrtarëve të niveleve të ndryshme rrit efektivitetin e betejës anti-korrupsion, pasi gazetarët dhe organizatat e shoqërisë civile luajnë një rol të rëndësishëm në zbulimin e parregullsive, duke shtyrë institucionet që të iniciojnë verifikime formale të aseteve që mund të jenë vendosur në mënyrë të paligjshme ose në kushtet e konfliktit të interesit. Ky rol i medias dhe i shoqërisë civile pritet të marrë një dimension të ri në Shqipëri gjatë zbatimit të reformës në drejtësi, e cila parashikon rivlerësimin kalimtar të të gjithë gjyqtarëve dhe prokurorëve në bazë të tri kriterëve, përfshirë dhe vlerësimin e pasurisë së tyre. Rivlerësimi i integritetit të anëtarëve të sistemit të drejtësisë bazohet në ndryshimet kushtetuese që u votuan unanimisht nga Parlamenti në korrik 2016, si dhe në një paketë ligjore që ndoqi amendimet e ligjit themeltar të shtetit shqiptar.

Në këtë kontekst, BIRN Albania ka ndërmarrë prej dy vitesh një proces kërkimor për zbardhjen dhe analizimin e të dhënave të deklaratave të pasurisë së gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë. Kjo sipërmarrje, që ka për qëllim të fuqizojë rolin mbikëqyrës të medias dhe shoqërisë civile në procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, i njohur ndryshe si procesi i 'vettingut', është iniciuar duke bërë kërkesa të bazuara në ligjin për të drejtën e informimit në ILDKPKI, për të siguruar kopje zyrtare të deklaratave të pasurisë së gjyqtarëve dhe prokurorëve që nga viti 2003, kur edhe ka filluar procesi i deklarimit të pasurisë në Shqipëri e deri në vitin e fundit të deklarimit të zyrtarit përkatës.

Nëpërmjet kërkesave për të drejtë informimi, BIRN Albania ka administruar nga ILDKPKI mbi 5000 deklarata pasurie për 423 gjyqtarë të shkallëve të ndryshme të sistemit gjyqësor. Në shifrat e sipërpërmendura përfshihen 3128 deklarata pasurie nga gjyqtarët e shkallës së parë në të gjitha gjykatat e rretheve gjyqësore, 959 deklarata pasurie nga gjyqtarët e Apelit, 207 deklarata pasurie nga gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, 106 deklarata pasurie nga gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese dhe

650 deklarata pasurie nga gjyqtarët e gjykatave administrative në vend.

Deklaratat e përfuara janë indeksuar dhe arkivuar, ndërkohë që të dhënat e pasurisë janë hedhur në një databazë të ndërtuar sipas praktikave më të mira ndërkombëtare për të analizuar asetet, detyrimet, të ardhurat dhe shpenzimet e gjyqtarëve, në mënyrë që të identifikohen të ashtuquajturit 'flamuj të kuq' ose rastet kur deklaratat përmbajnë të dhëna që krijojnë dyshime të arsyeshme për burime të paligjshme të pasurisë. Gjithashtu, deklaratat e çdo gjyqtari i janë nënshtruar kontrollit aritmetik-logjik, një procedurë që zbatohet çdo vit për secilin subjekt nga ILDKPKI dhe ka për qëllim të vlerësojë saktësinë e pasurisë së deklaruar, saktësinë e burimeve financiare të deklaruara dhe mjaftueshmërinë e mbulimit të pasurive nga burimet e deklaruara.

Gjatë viteve 2016-2017, me ndihmën e ekspertëve në fushën e deklarimit dhe kontrollit të pasurive, BIRN Albania ka publikuar katër studime mbi integritetin e pasurisë së gjyqtarëve të shkallës së parë, të Apelit, të Gjykatës së Lartë dhe Gjykatës Kushtetuese. Këto studime kanë treguar se pasuria e deklaruar e këtyre gjyqtarëve ngre një seri 'flamujsh të kuq', si për shembull shuma të larta humarrjeje jashtë sistemit bankar, detyrime të larta ndaj kompanive të ndërtimit apo të ardhura të larta nga biznesi, shitja e pasurive të luajtshme/palujtshme apo dhurata dhe qiradhënia. Studimet e mëparshme kanë treguar gjithashtu se një përqindje e lartë e gjyqtarëve dështojnë të paktën në një vit të karrierës së tyre në kontrollin aritmetik- logjik.

Sipas analizës së deklaratave të pasurisë, 79% e gjyqtarëve të gjykatave të Apelit dhe 10 nga 17 anëtarët e Gjykatës së Lartë dështuan në kontrollin aritmetik- logjik në të paktën një vit të karrierës së tyre. Sipas të njëjtës analizë, vetëm dy prej anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese e kaluan testin e justifikimit të pasurisë për të gjitha vitet e deklaruara. Të dhënat e këtyre studimeve janë bërë publike nga BIRN Albania nëpërmjet botimit të tyre si dhe tryezave të rumbullakta me gazetarë dhe ekspertë të shoqërisë civile. Të dhënat janë shpërndarë për publikun e gjerë edhe nëpërmjet artikujve në mediane dhe shkruar dhe atë audiovizive. BIRN Albania ka vënë në dispozicion të gazetarëve të interesuar akses në databazën e të dhënave dhe ekspertizë të specializuar, për të ndihmuar në hulumtimin e rasteve të korrupsionit dhe konfliktit të interesit në gjykata. Nën gjurmët e tre studimeve të mëparshme të botuara, BIRN Albania sjell tashmë një analizë të thelluar të deklaratave të pasurisë së 48 gjyqtarëve të Gjykatave Administrative në vend.

## *Qëllimi i këtij studimi*

Të dhënat parësore të këtij studimi bazohen në analizimin sasior dhe cilësor të vetëdeklarimeve të pasurisë së 48 gjyqtarëve të Gjykatave Administrative, të marra nga ILDKPKI nëpërmjet kërkesave për kopje të dokumenteve publike, bazuar në Ligjin nr. 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit". Të dhënat



dytësore për këtë studim bazohen në raportet e botuara më parë mbi këtë fushë, si dhe praktikrat më të mira ndërkombëtare për vlerësimin dhe kontrollin e pasurisë së zyrtarëve të zgjedhur dhe të emëruar.

Objekt i këtij studimi janë gjyqtarët e Gjykatave Administrative të shkallës së parë dhe gjyqtarët e Gjykatës Administrative të Apelit, të cilët kanë qenë në funksion deri në dorëzimin e deklarimit periodik/vjetor 2017 pranë Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive. Bazuar në këtë kriter përzgjedhës janë marrë kopje të deklaratave të interesave private për 48 gjyqtarë të Gjykatës Administrative, duke krijuar një bazë krahasuese për pasurinë e tyre dhe burimin financiar të deklaruar, për shkak edhe të shtrirjes kohore në sistemin e deklarimit të pasurisë.

Studimi hedh dritë jo vetëm mbi mënyrën e akumulimit të pasurisë nga gjyqtarët, por edhe mbi teknikat e fshehjes së origjinës së kësaj pasurie; ku përfshihen dhurata apo huamarrje nga familjarë dhe persona të lidhur, pasuri të shumta të trashëguara, kredi bankare në vlera të konsiderueshme, transaksione të shumta imobiliare dhe qiradhënie, si dhe mbajtja e likuiditeteve Cash jashtë sistemit bankar.

Bazuar në sa më lart, ky raport ka për qëllim të ofrojë një panoramë të qartë mbi strukturën dhe burimin financiar të pasurisë së deklaruar të gjyqtarëve të Gjykatave Administrative, duke ofruar informacion të mjaftueshëm mbi ndryshimet që ka pësuar pasuria e tyre, strukturën e detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve – të dhëna që autorët e studimit shpresojnë se do të ndihmojnë gazetarët, ekspertët dhe shoqërinë civile për të mbikëqyrur në mënyrë të pavaruar punën e institucioneve të vetingut, që po kryejnë procesin e verifikimit të pasurive të gjyqtarëve dhe prokurorëve.

## Organizimi i Gjykatave Administrative në Republikën e Shqipërisë

Gjykata kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative janë gjykatat administrative të shkallës së parë, Gjykata Administrative e Apelit dhe Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë.

Gjykatat administrative të shkallës së parë organizohen në numër dhe për territor të barabartë me atë të gjykatave të apelit civil, pra në 6 qytete dhe konkretisht në Tiranë, Shkodër, Durrës, Korçë, Gjirokastër dhe Vlorë.

### Gjykatat administrative janë kompetente për:

a) mosmarrëveshjet që lindin nga aktet administrative individuale, aktet nënligjore normative dhe kontratat administrative publike, të nxjerra gjatë ushtrimit të veprimtarisë administrative nga organi publik;

b) mosmarrëveshjet që lindin për shkak të ndërhyrjes së paligjshme ose të mosveprimit të organit publik;

c) mosmarrëveshjet e kompetencave ndërmjet organeve të ndryshme administrative në rastet e parashikuara nga Kodi i Procedurave Administrative [xi] ;

d) mosmarrëveshjet në fushën e marrëdhënieve të punës të nëpunësve civilë, nëpunësve civilë gjyqësorë, nëpunësve civilë të prokurorisë dhe të nëpunësve shtetërorë.

e) kërkesat e paraqitura nga organet administrative për shqyrtimin e kundërvajtjeve administrative, për të cilat ligji parashikon heqjen e lirisë deri në 30 ditë, si një lloj të dënimit administrativ për kundërvajtësin;

f) kërkesat e paraqitura nga kundërvajtësit për zëvendësimin e dënimit administrativ me heqje lirie deri në 30 ditë me dënimin me gjobë.

Gjykata Administrative e Apelit aktualisht është një e vetme dhe selia e saj është në Tiranë.

## Gjykata Administrative e Apelit shqyrton:

a) ankimet kundër vendimeve të gjykatës administrative të shkallës së parë me trup gjykues prej 3 gjyqtarësh;

b) si shkallë e parë (juridiksion fillestar), mosmarrëveshjet me objekt aktet nënligjore normative, me trup gjykues prej 5 gjyqtarësh.



## II. Metodologjia e studimit

### Kampionimi

Ky studim është bazuar në përpunimin dhe analizimin e të dhënave të deklaratave të pasurisë së 48 gjyqtarëve të shtatë Gjykatave Administrative në vend. Në Tabelën 1 më poshtë paraqiten në mënyrë të detajuar numri i gjyqtarëve dhe numri i deklaratave për secilën gjykatë:

**Tabela 1: Numri i gjyqtarëve dhe i deklaratave sipas gjykatave:**

Institucioni	Numri i Subjekteve	Numri i deklaratave
Gjykata Administrative e Apelit	13	194
Gjykata Administrative Tiranë	15	197
Gjykata Administrative Durrës	4	48
Gjykata Administrative Gjirokastrë	7	97
Gjykata Administrative Korçë	3	40
Gjykata Administrative Shkodër	2	30
Gjykata Administrative Vlorë	4	44
<b>Total</b>	<b>48</b>	<b>650</b>

Deklaratat e pasurisë janë aksesuar në mënyrë elektronike nga ILDKPKI, pas kërkesës me shkrim drejtuar këtij institucioni, bazuar në ligjin nr.119, datë 18.09.2014 *“Për të drejtën e informimit”*. Secili formular deklarimi përmban të gjitha të dhënat e deklaruara nga subjekti deklarues, përveç të dhënave konfidenciale (siç janë: faqja e shpenzimeve të deklarueshme, të dhëna si p.sh. adresat e shtëpive, numrat e llogarive bankare, emrat e personave të tretë etj.).

Për qëllim të këtij studimi janë marrë në analizë të gjithë formularët e deklarimit të gjyqtarëve, nga deklarimi i parë (Deklarata Para Fillimit të Detyrës) si dhe çdo deklarim periodik/vjetor i interesave private deri në vitin 2017. Në çdo rast, kur në këtë studim citohet pasuria/detyrimet/të ardhurat apo shpenzimet e gjyqtarit, duhet nënkuptuar gjyqtari dhe familjarët e tij, përveç rasteve kur do të shprehet në mënyrë specifike pronësia e familjarëve si e ndarë më vete nga ajo e gjyqtarit (si subjekt deklarues).

Bazuar në sa më lart, objekti i analizës së këtij studimi janë 650 deklaratat të interesave private që i përka-sin 48 gjyqtarëve që kanë qenë në funksion si subjekte të deklarimit të pasurisë deri më datë 31.12.2017.

## Hedhja e të dhënave në Database (bazën e të dhënave)

Të dhënat e deklaratave të interesave private janë regjistruar në bazën e të dhënave sipas një standardi unifikues, i ndjekur me përpikmëri nga ekspertët e angazhuar me procesin e hedhjes së të dhënave. Për të kryer një kategorizim të saktë të të dhënave të deklaratave të pasurisë, ky studim i është referuar dy ligjeve bazë të ILDKPKI-së si dhe Udhëzimeve për plotësimin e formularëve të deklarimit të interesave private, i miratuar nga Inspektori i Përgjithshëm i ILDKPKI-së.

Baza e të dhënave (database) është ndërtuar në formatin Excel, në formë tabelare, duke bërë të mundur që çdo e dhënë e deklaratës që hidhet në këtë tabelë, të jetë e qartë, e plotë dhe lehtësisht e identifikueshme se cilit subjekt i përket, cilës deklaratë, cilit vit, kategori, etj. Çdo e dhënë e pasqyruar në deklaratat e interesave private është “zbërthyer” dhe hedhur në qelizat përkatëse.

Përveç gjeneraliteteve dhe të dhënave mbi funksionin e gjyqtarit, datës së emërimit në detyrë, institucionin ku ka ushtruar profesionin përgjatë të gjitha viteve, etj., pjesa më e rëndësishme është informacioni i deklaruar lidhur me pasurinë, detyrimet, të ardhurat dhe shpenzimet. Këto të dhëna janë grupuar në katër kategori të mëdha: (1) asete; (2) detyrime; (3) të ardhura dhe (4) shpenzime.

Secila nga këto kategori është detajuar në nënkategori, duke iu referuar përkufizimeve të nenit 4 të ligjit Nr.9049, datë 10.04.2003 *“Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”*, për objektin e deklarimit si dhe rasteve më tipike të ndeshura në formularët e deklarimit, siç është përshembull: detyrimi i mbetur pa shlyer ndaj shoqërive sipërmarrëse, të ardhurat nga shitja e pasurive të paluajtshme (e shprehur si formë fitimi për shkak të transaksionit të blerjes dhe shitjes me diferencë çmimi) etj. Të gjitha nënkategoritë e përdorura në kodifikimin e të dhënave të deklaruara nga gjyqtarët dhe familjarët e tyre janë të pasqyruara në Aneksin I të këtij raporti ‘Kodifikimi i Kategorive dhe Nënkatëgorive’.

Kolona e kategorive dhe nënkategorive është e plotësuar me kodet dhe nënkodet sipas tabelës së paraqitur në Aneksin I, me qëllim unifikimin e të dhënave dhe mundësimin e përpunimit të të gjithë informacionit të disponueshëm.

Kur deklarimi është bërë nga personat e lidhur, ky fakt evidentohet në kolonën “person i lidhur” duke plotësuar një nga opsionet, nëse bëhet fjalë për bashkëshort/e; fëmijë; apo të tjerë (si prindër, motra, vëllezër), që pavarësisht se nuk kanë detyrim ligjor për të deklaruar, shpeshherë janë përfshirë në vetëdeklarim.

Të dhënat e tjera që i përkasin kategorive: (1) asete; (2) detyrime; (3) të ardhura dhe (4) shpenzime, janë

regjistruar fillimisht në versionin narrativ, duke pasqyruar saktësisht çfarë ka deklaruar subjekti, dhe më pas në kolonën "shuma në Lekë" është përlogaritur vlera në Lekë sipas deklarimit.

Në rastet kur është deklaruar vlera në monedhë të huaj, në kolonën "shuma në Lekë" është bërë konvertimi në Lekë, sipas kursit të këmbimit të Bankës së Shqipërisë me datë 31 Dhjetor të vitit të cilit i përket deklarimi. Në Aneksin II të këtij raporti janë pasqyruar në mënyrë të detajuar të gjitha kurset e këmbimit të përdorura sipas viteve përkatëse, për monedhat EURO, USD, GBP, CHF, CAD.

Kur në deklaratat Periodike/Vjetore, gjyqtarët dhe familjarët e tyre kanë deklaruar pakësim të aseteve apo shitje të aseteve në pronësi (të deklaruara në deklaratat e mëparshme), regjistrimi i vlerës së këtij asetit të shitur ose të pakësuar është shënuar me minus (-). Këtu dallohen dy raste:

Në rastet e shitjes së pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme, vlera që pakësohet është çmimi i asetit siç është deklaruar në periudhën e krijimit. Pra, pasqyrohet pakësimi i asetit në kategorinë e aseteve. Në rastet kur ka pasur diferencë mes çmimit të shitjes dhe çmimit të blerjes, atëherë kjo diferencë është pasqyruar në kategorinë e të ardhurave- si burim të ardhurash për periudhën e deklarimit.

Në rastin e pakësimit të likuiditeteve (Cash, bankë), pra kur deklarohet pakësim apo tërheqje depozite apo gjendje Cash, ky veprim është regjistruar në kategorinë e aseteve duke vendosur në kolonën "shuma në Lekë" shumën që është pakësuar me shenjën minus (-).

Për pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme, të cilat janë deklaruar si dhurata, regjistrimi i vlerës së tyre është shënuar zero lekë (0) në rastet kur nuk është shënuar vlerë.

Për çdo dhuratë të deklaruar në formë aset apo shpenzimi, në bazën e të dhënave është bërë regjistrimi i dyfishtë, duke pasqyruar vlerën e dhuruar si aset apo shpenzim, si dhe burimin si e ardhur nga dhurata (kjo e fundit është regjistruar si një nënkategori e veçante tek të ardhurat).

Në rastin kur janë deklaruar pasuri të paluajtshme të përfituara nga Ligji nr.7501, është shënuar vlera zero lekë (0) për ato raste kur vetë subjekti nuk ka shënuar vlerë.

Përsa i përket shlyerjes së kësteve të kredisë apo detyrimeve të tjera, të cilat janë deklaruar në rubrikën e detyrimeve në formularin e deklarimit, ka qenë e pamundur të ndahet pjesa e principalit nga interesi i paguar, pasi në çdo rast është deklaruar në total kësti i paguar. Meqenëse interesi duhej të ishte trajtuar si shpenzim, ndërsa principalin si pakësim i detyrimeve dhe në kushtet kur ky informacion mungon, atëherë kësti i paguar në total është trajtuar si pakësim detyrimesh.

Në rastet kur një detyrim i lindur brenda periudhës deklaruese (qoftë kjo kredi, huamarrje, etj.) është kthyer po brenda vitit apo periudhës deklaruese, atëherë ky veprim regjistrohet dy herë në kategorinë e detyrimeve: një herë vlerë pozitive dhe një herë si pakësim detyrimi, pra me minus (-).


Në shumë raste ka pasur përsëritje të aseteve dhe detyrimeve, duke shënuar në dy ose më shumë vite rresht të njëjtat të dhëna. Ky informacion është pasqyruar në kolonën "Përshkrimi" në bazën e të dhënave, ndërsa në kolonën "shuma në Lekë" është shënuar vlera zero lekë (0), me qëllim shmangien e shtesës artificiale të pasurisë apo detyrimeve në emër të zyrtarëve, objekt i këtij studimi.

Në rastin e likuiditeteve (Cash apo në bankë), subjektet deklarues nuk kanë respektuar në çdo rast detyrimin ligjor për të deklaruar ndryshimet në krahasim me vitin paraardhës, pra shtesa apo pakësime, por kanë deklaruar gjendjen në fund të periudhës deklaruese. Kur ka qenë i mundur identifikimi dhe lidhja logjike e gjendjes aktuale me të dhënat e deklaruara në vitin paraardhës, ekspertët kanë përllogaritur sa ka qenë ky ndryshim në vlerë monetare. Në rastet kur ka qenë i pamundur identifikimi se cila llogari bankare ka ndryshuar, atëherë është marrë si e mirëqenë që shuma e deklaruar është shtesë për periudhën.

Në rastet kur subjekti ka deklaruar se pasuria e paluajtshme është rivlerësuar, sipas ligjeve në fuqi, është shënuar vlera e rivlerësuar e objektit, me qëllim që të përftohet një vlerë reale të pasurive aktuale në pronësi të subjektit. Me qëllim justifikimin e shtimit të vlerës, është shtuar një nënkategori e re tek të ardhurat, Rivlerësimi i pasurive të paluajtshme.

## Analizimi i të dhënave

Pas hedhjes në Database (formati Excel) të të dhënave të deklaratave të interesave private nga fillimi i detyrës deri me datë 31.12.2017 për 48 gjyqtarë, filloi faza e analizimit dhe përpunimit të të dhënave. Mënyra e përpunimit të të dhënave dhe e paraqitjes grafike është bërë me metodën Pivot Table and Pivot Chart. Përpunimi i të dhënave me Pivot Table ofron fleksibilitet dhe saktësi në gjenerimin e tabelave dhe raporteve, si dhe paraqitje grafike me ilustrime të qarta e lehtësisht të interpretueshme.





## Kufizime të metodologjisë

Në disa nga rubrikat e formularit të deklarimit janë konstatuar parregullsi në mënyrën e plotësimit të formularit. Disa nga elementët e marrë parasysh gjatë hedhjes së të dhënave të deklaratave dhe kontrollit të tyre, të cilat njëkohësisht janë dhe sinjalizues të pakujdesive ose gabimeve në plotësimin e deklaratave dhe analizimin e tyre janë:

- Në deklaratat Periodike/Vjetore është deklaruar gjendja e likuiditeteve në vend që të deklarohet ndryshimi i gjendjes (shtesë apo pakësim) krahasuar me vitin paraardhës;
- Është rideklaruar i njëjti aset dhe/apo detyrim, në dy ose më shumë periudha deklaruese;
- Është deklaruar nga vetë subjekti pasuria dhe detyrimet në emër të personave të lidhur (bashkëshort/e, fëmijë madhorë), të cilët duhet të ishin plotësuar nga vetë personat e lidhur në formularin përkatës në faqet nr.7-12;
- Është deklaruar shitje e një prone të padeklaruar më parë, në deklaratat paraardhëse;
- Deklarimi jo i plotë i të dhënave lidhur me kontratat e sipërmarrjes, për rastin kur jepet trualli për ndërtim dhe nuk është e qartë pjesa takuese që përfiton subjekti;
- Deklarimi i transaksioneve të biznesit të familjarëve, si fatura shitblerjeje, llogari të arkëtueshme etj.
- Mungesë informacioni nga ana e subjektit deklarues lidhur me destinacionin e të ardhurave nga shitja e pasurive të paluajtshme (nëse janë riinvestuar, mbahen cash apo janë shpenzuar);
- Në rubrikën e të ardhurave dhe detyrimeve është deklaruar shënimi “nuk ka ndryshim”, por subjekti deklarues ka pasur detyrimin ligjor të deklarojë saktësisht të ardhurat neto për atë periudhë dhe shlyerjen e pagesës vjetore (pasi ka deklaruar detyrimeve në periudhën parardhëse);
- Ka mungesë firmash në faqet e plotësuara nga gjyqtarët, pra në faqet ku ka të dhëna dhe nënshkrimi është i detyrueshëm;
- Nuk janë shënuar me fjalë vlerat dhe çmimet, por vetëm me shifra; ose ka raste kur vlera me shifra është e ndryshme nga vlera në lekë; subjektet kanë deklaruar vlera me lekë të vjetër dhe jo me lekë të rinj;
- Një kufizim i rëndësishëm është dhe trajtimi si informacion konfidencial nga ana e ILDKPKI-së i **shpenzimeve të deklarueshme**.

Nga sa u përmendën në pikat e mësipërme, nënkuptohet se edhe analiza statistikore ka një marzh gabimi, në raport të drejtë me gabimet materiale që janë gjendur në formularët e deklarimit.

### III. Gjetjet e studimit

Gjatë 3 viteve të fundit, BIRN Albania ka ngritur një metodologji të konsoliduar për kontrollin dhe vlerësimin e pasurive të zyrtarëve publikë, e cila është bazuar në eksperiencën ndërkombëtare dhe praktikën më të mira për sistemet e kontrollit të pasurisë së deklaruar. Kjo metodologji tashmë është aplikuar në pesë studime të mëparshme, në vlerësimin dhe analizën e pasurisë së gjyqtarëve të Gjykatave të Apelit, Gjykatës së Lartë, Gjykatës Kushtetuese, Gjykatave të Rretheve Gjyqësore dhe Prokurorisë.

Ashtu si edhe në vende të tjera, procedura e deklarimit dhe e kontrollit të pasurisë së zyrtarëve publikë në Shqipëri ndahet nga ILDKPKI në regjistrimin e formularëve të deklarimit të pasurisë, përpunimi para-prak i tyre, kontrolli aritmetik dhe logjik dhe në raste të caktuara, verifikimi ose hetimi administrativ.

Për identifikimin e trendeve që përdoren nga këto subjekte për të legalizuar pjesë të paligjshme të pasurisë së tyre, të cilat në praktikën më të mira ndërkombëtare identifikohen si 'flamuj të kuq', BIRN ndërmoi një analizë të detajuar të strukturës së asetëve, të detyrimeve, të të ardhurave dhe shpenzimeve të gjyqtarëve të Gjykatave Administrative gjatë periudhës 2003-2017.

Sipas praktikave më të mira ndërkombëtare në fushën e deklarimit dhe kontrollit të pasurive, të gjithë 'flamujt e kuq' duhej të ishin shtysë për organe si ILDKPKI për të filluar një audit të plotë për subjektin për të cilin ato konstatohen. Një audit i plotë ka për qëllim përdorimin e të gjitha mundësive përtej deklaratës, për të identifikuar pasuri të padeklaruara nga ana e subjektit, të cilat çojnë në zbulimin e burimeve financiare të paligjshme. Objekti i një auditi ose kontrolli të plotë administrativ nuk është deklarata në vetvete, por subjekti deklarues dhe personat e lidhur, me të cilët ai ka kryer transaksione financiare. Qëllimi i kontrollit të plotë administrativ është që institucioni/Inspektorati të sigurohet që të ardhurat e zyrtarit dhe të familjarëve të tij kanë burim të ligjshëm, të hetojë nëse ka pasuri të fshehura si dhe të identifikojë çdo lloj shpenzimi të kryer, që mund të jenë krijuar me të ardhura të paligjshme.

Nga një lexim formal i formularëve të deklarimit të interesave private të gjyqtarëve të Gjykatave Administrative rezulton se pjesë e këtij studimi janë gjyqtarë me vite të ndryshme karriere, ku 29 prej tyre (60%) kanë qenë të emëruar në detyrë dhe deklarojnë interesat private pranë ILDKPKI-së që në vitin 2003 ose 2004. Pjesa tjetër është emëruar në detyrë në vitet pasardhëse, siç tregohet dhe në Tabelën 2 më poshtë.

**Tabela 2: Numri dhe përqindja e gjyqtarëve të emëruar në detyrë sipas viteve.**

Viti i emërimit në detyrë	Nr.subjecteve	%
Para ose gjatë vitit 2003	29	60%
Viti 2004	4	8%
Viti 2005	8	17%
Viti 2006	2	4%
Viti 2008	1	2%
Viti 2009	1	2%
Viti 2015	3	6%
<b>Total</b>	<b>48</b>	<b>100%</b>

Pra, janë gjithsej 48 gjyqtarë të Gjykatave Administrative, të cilët kanë deklaruar interesat private pranë ILDKPKI-së për periudhën 2003-2017. Numri i përgjithshëm i formularëve të deklarimit që këta gjyqtarë kanë plotësuar është 650 deklarata, të cilat janë administruar dhe kontrolluar nga ILDKPKI dhe janë objekt i këtij studimi të ndërmarrë nga BIRN.

Në mungesë të të dhënave mbi hetimet administrative të ndërmarra nga ILDKPKI, për të vlerësuar punën e këtij institucioni, BIRN analizoi të dhënat e mbedhura nga 650 deklaratat e interesave private. Qëllimet kryesore të kësaj analize janë:

- Identifikimi i "flamujve të kuq" ose i rasteve kur deklaratat përmbajnë të dhëna që krijojnë dyshime për burime të paligjshme të pasurisë, bazuar në standartet më të mira ndërkombëtare, të cilat duhet të shërbejnë si indicie për hetime më të thelluara të deklaratave;
- Kryerja e kontrollit aritmetik-logjik të deklaratave të pasurisë së gjyqtarëve të Gjykatave Administrative në Republikën e Shqipërisë. Kontrolli aritmetik dhe logjik kryhet çdo vit kalendarik dhe për çdo deklarim nga Inspektoriat, për të vërtetuar saktësinë e vlerësimit të pasurisë së deklaruar, saktësinë e burimeve financiare të deklaruara dhe mjaftueshmërinë e mbulimit të pasurive nga burime të deklaruara. Duke qenë se ky kontroll mbështetet vetëm tek të dhënat e deklarimeve të subjekteve dhe të familjarëve të tyre, BIRN përzgjedhi këtë metodë kontrolli për të analizuar në mënyrë të pavarur pasurinë e këtyre gjyqtarëve si dhe punën e Inspektoriatit për të identifikuar të dhëna statistikore mbi pasuri dhe asete të ngritura me burime të paligjshme;

Bazuar në këto dy objektiva, seksionet e mëposhtme përmbledhin gjetjet mbi: *Asetet ose Pasurinë Bruto*; *Detyrimet* e deklaruara prej tyre; përlllogaritjen e *Pasurisë Neto* bazuar në të dhënat e kategorive

Asete dhe Detyrime; *Të Ardhurat* dhe *Shpenzimet* e deklaruar; përlllogaritjen e të *Ardhurave Neto*; rezultatet e *Kontrollit aritmetik-logjik* të deklaratave periodike/vjetore; përlllogaritjen mbi *Pasurinë e pajustificuar* të gjyqtarëve, si dhe përlllogaritja e shpenzimeve vjetore për secilin prej këtyre subjekteve.

Pra, objekt i këtij studimi janë **650 deklaratat** të interesave private, të administruara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave.

## 1. INTERESAT PRIVATE– PASURIA BRUTO

Në konceptin e pasurisë bruto përfshihet çdo interes privat i deklaruar nga zyrtarët dhe familjarët e tyre në formularin e deklarimit të pasurive, të cilat janë kategorizuar referuar nenit 4 të ligjit nr.9049 datë 10.4.2003, “Për Deklarimin dhe Kontrollin e Pasurive, të Detyrimeve Financiare të të Zgjedhurve dhe të disa Nëpunësve Publikë”, i ndryshuar.

**Në kategorinë Pasuria Bruto, përfshihen këto nënkategori:**

- Pasuri të paluajtshme;
- Pasuri të luajtshme;
- Likuiditete në Cash;
- Likuiditete në Bankë;
- Pjesë në kapital/Aksione;
- Person Fizik;
- Sende me vlerë të veçantë;
- Huadhënie;
- Asete të tjera (për ato asete që nuk i përkasin kategorive të mësipërme).

Mënyra e deklarimit të interesave private nga subjekti deklarues konsiston në deklarimin e gjendjes së interesave private që ai disponon, burimin e krijimit dhe detyrimet financiare në momentin e marrjes së detyrës dhe ky deklarim quhet Deklarimi Para Fillimit të Detyrës; ndërsa në deklaratat në vijim, pra në deklaratat Periodike/Vjetore, zyrtari ka detyrimin ligjor të deklarojë ndryshimet e interesave private dhe detyrimeve për periudhën deklaruese, çdo të ardhur neto si dhe shpenzimet e deklarueshme.

Për këtë arsye, në përlllogaritjen e vlerës së Aseteve dhe Detyrimeve në një moment të caktuar kohor është e rëndësishme të përlllogaritet vlera akumulative, duke filluar nga deklaratat fillestare.

Përkufizimet e mëposhtme ndihmojnë në kuptimin më të mirë të analizës së vlerës së aseteve:

- *Interesat Private/ Pasuria bruto fillestare* – Çdo interes privat që subjekti deklarues dhe familjarët e tij zotërojnë në fillim të procesit të vetëdeklarimit;
- *Shtesat / Pakësimet vjetore* – Vlera e shtuar apo e pakësuar e interesave private për secilin vit deklarues; si dhe
- *Vlera akumulative e aseteve* – Ndryshimet në interesa private/ pasuri bruto ndër vite, në të cilën përfshihen vlera fillestare plus shtesat ose pakësimet vjetore të tyre.

### 1.a. Ndryshimet në pasurinë bruto

#### SI KA NDRYSHUAR PASURIA BRUTO NGA FILLIMI I DETYRËS DERI NË VITIN 2017?

Analiza e mundësuar nga baza e të dhënave, e ngritur për qëllime të këtij studimi tregon se gjendja fillestare e deklaruar e pasurisë së 48 gjyqtarëve të Gjykatave Administrative (bazuar në deklaratat Para Fillimit të Detyrës) është në shumën 97,444,325 Lekë (rreth 97 milionë lekë). Kjo vlerë nënkupton se mesatarisht një gjyqtar ka zotëruar pasuri me vlerë rreth 2 milionë lekë (2,030,090 lekë) në momentin fillestar të detyrimit ligjor për deklarimin e pasurisë.

Pas të gjitha ndryshimeve të deklaruara për gjendjen pasurore, nga deklarimi i parë deri në vitin 2017 (ku janë përlllogaritur shtesa dhe pakësime sipas konceptit të plotësisimit të formularit të deklarimit) rezulton se shuma totale e pasurisë bruto akumulative në fund të vitit 2017 është rreth 844 milionë lekë (844,460,748 lekë), pra mesatarisht rreth 17.6 milionë lekë (17,592,932 lekë) për një subjekt (Tabela 3).

**Tabela 3: Ndryshimet në vlerën akumulative të pasurisë bruto nga fillimi i detyrës së 48 gjyqtarëve deri në fund të vitit 2017**

Përshkrimi	Para Fillimit	Datë 31.12.2017
Vlera totale e pasurisë bruto në Lekë	97,444,325	844,460,748
Pasuria bruto në fund të vitit 2017 është 8.7 herë më e madhe se pasuria para fillimit të detyrës		
Shtesa totale e pasurisë nga fillimi i detyrës deri me dt.31.12.2017 është 747,016,423 lekë		
Shtesa mesatare e pasurisë për një gjyqtar nga fillimi i detyrës deri më dt.31.12.2017 është 15,562,842 Lekë		

Pasuria akumulative e 48 gjyqtarëve të Gjykatave Administrative dhe familjarëve të tyre në fund të vitit 2017 rezulton të jetë rritur me 747,016,423 lekë, ose e thënë ndryshe, pasuria bruto është rritur rreth 8.7 herë krahasur me gjendjen fillestare të deklarimit.

Për të analizuar më me detaje rritjen akumulative të pasurisë bruto përgjatë 14 viteve të vetëdeklarimeve të marra në shqyrtim, krahasur me gjendjen fillestare të deklarimit, në Tabelën 4 paraqiten shtesat në pasurinë bruto për secilin vit kalendarik si dhe ndikimi i tyre në rritjen e vlerës akumulative të kësaj pasurie për 48 gjyqtarë, subjekte të këtij raporti.


**Tabela 4: Vlera akumulative e pasurisë bruto ndër vite**

Viti i emërimit në detyrë	Të emëruarit sipas viteve	Pasuria Bruto Progressive
2003	29	40.197.200
2004	33	73.008.071
2005	41	113.004.797
2006	43	176.482.716
2007	43	205.785.143
2008	44	251.632.013
2009	45	301.985.207
2010	45	375.058.026
2011	45	414.937.574
2012	45	478.184.960
2013	45	536.410.808
2014	45	574.189.311
2015	48	731.293.221
2016	48	793.320.022
2017	48	844.460.748

Siç shihet nga Tabela 4, ndryshimi i pasurisë bruto është në rritje të vazhdueshme. Subjektet që kanë qenë në detyrë (29 gjyqtarë) që në vitin 2003, kanë deklaruar pasuri totale në shumën 40,197,200 lekë. Numri i të emëruarve që i shtohen Gjykatave Administrative ka pësuar rritje deri në vitin 2015 dhe të emëruarit e rinj kanë ndikuar në rritjen e vlerës së pasurisë bruto deri në 844,460,748 lekë. Pra në rritjen progresive të pasurisë bruto, ndikim parësor ka shtimi i numrit të gjyqtarëve. Por vëmë

gjithashtu re se në periudhat kur numri i gjyqtarëve është konstant, vlera e pasurisë ka rritje, gjë që kërkon një studim më të detajuar të elementëve që kanë ndikuar në rritjen e pasurisë. Në grafikun më poshtë ilustrohet më qartë kjo varësi mes numrit të gjyqtarëve dhe rritjes së pasurisë.

**Grafiku 1: Vlera akumulative e deklaruar e pasurisë bruto ndër vite krahasuar me rritjen e numrit të gjyqtarëve në Gjykatat Administrative.**



**Tabela 5: Pasuria mesatare vjetore sipas intervaleve dhe numri i subjekteve**

Intervali i pasurise mesatare vjetore	Numri i subjekteve	%
0-500,000 lekë	12	25%
500,001-1,000,000 lekë	15	31%
1,000,001-2,000,000 lekë	14	29%
2,000,001-4,500,000 lekë	7	15%
<b>Total</b>	<b>48</b>	<b>100%</b>

Duke analizuar më tej nëse kohëzgjatja në detyrë ndikon në shtimin e pasurisë, rezultatet tregojnë se ndër gjyqtarët me rritje mesatare të pasurisë mbi 2,000,000 lekë në vit, 95% e tyre kanë mbi 12 vite karrierë në gjyqësor dhe 5% kanë vetëm 8 vite karrierë; ndërsa në intervalin e shtesës së pasurisë mesatare vjetore deri në 1,000,000 lekë, konstatohet se 85% e gjyqtarëve kanë mbi 10 vite punë në sistemin gjyqësor, ndërsa 15% e tyre kanë 2-7 vite karrierë.

### **1.b. Nënkatëgoritë e interesave private/aseteve**

#### **CILAT JANË LLOJET E INTERESAVE PRIVATE DHE RAPORTI NDËRMJET TYRE?**

Nënkatëgoritë që përbëjnë totalin e vlerës së asetëve të deklaruar nga gjyqtarët e Gjykatave Administrative në mënyrë përmbljedhëse janë klasifikuar në: Pasuri të paluajtshme; Pasuri të luajtshme; Likuiditete në Cash; Likuiditete në Bankë; Pjesë në kapital/Aksione; Person Fizik; Sende me vlerë të veçantë; Huadhënie; dhe Asete të tjera për ato asetë që nuk i përkasin kategorive të mësipërme.

Raporti ndërmjet këtyre nënkategorive në vlerë në Lek dhe në përqindje, për të gjithë gjyqtarët objekt i këtij studimi, është prezantuar në Tabelën 6 më poshtë.

**Tabela 6: Vlera akumulative në lekë për secilën nënkategori asetesh dhe raporti mes tyre.**

Pasuria sipas kategorive	Shuma në Lek	Raporti në %
Pasuri të Paluajtshme	500.688.624	59,3%
Likuiditete në Bankë	185.166.115	21,9%
Likuiditete në Cash	103.890.384	12,3%




Pasuri të Luajtshme	36.114.295	4,3%
Huadhënie	15.286.426	1,8%
Asete të tjera	1.759.950	0,2%
Person Fizik	1.154.953	0,1%
Pjesë në kapital/Aksione	400.000	0,05%
<b>Total</b>	<b>844.460.748</b>	<b>100%</b>

Siç tregojnë dhe të dhënat e paraqitura në Tabelën 6, pjesën më të madhe (99.6%) të vlerës së pasurisë bruto të gjyqtarëve, e zënë pesë nënkategori kryesore asetesh, respektivisht: Pasuri të Paluajtshme 59.3%; Likuiditete në Bankë 21.9%; Likuiditete në Cash 12.3%; Pasuri të Luajtshme 4.3% dhe Huadhënie 1.8%. Të grupuara në vetëm 0.4% përmbledhen zërat e tjerë të kategorisë së aseteve si: aktiviteti si person fizik, aksione/pjesë në kapital apo asete të tjera që nuk përfshijnë kategoritë e mësipërme.

Në një vështrim më të detajuar, nënkategoritë kryesore të aseteve paraqesin të dhëna si më poshtë vijon:

**Pasuri të Paluajtshme:** pasuritë e paluajtshme për 48 gjyqtarët e Gjykatave Administrative kapin 500,688,624 lekë, pasuri të cilat përbëjnë dhe 59.3% të aseteve të tyre të deklaruara. Ashtu siç tregon dhe Grafiku 2 më poshtë, vlera në lekë e pasurive të paluajtshme të gjyqtarëve është rritur në mënyrë të vazhdueshme në vitet e deklarimit të marra në shqyrtim, nga 73,636,994 lekë në deklarimin për herë të parë në vitin 2003 deri në 500,688,624 lekë në fund të vitit 2017, duke shënuar një rritje me 6.8 herë nga deklarimi fillestar.

**Grafiku 2: Vlera totale e pasurive të paluajtshme ndër vite, e paraqitur në mënyrë progresive e shprehur në lekë.**



Të dhënat e studimit sugjerojnë se mesatarisht çdo gjyqtar e ka rritur vlerën e pasurive të paluajtshme nga 1.5 milionë lekë në fillim të detyrës në rreth 10.4 milionë lekë vitin 2017. Në këtë vlerësim nuk janë përfshirë pasuritë e paluajtshme të përfituara nga trashëgimia apo të dhuruara, për të cilat subjektet deklarues nuk kanë shënuar vlerë në formularin e deklaramit.


Duke analizuar nga afër kategorinë e pasurive të paluajtshme, rezulton se mënyra kryesore në rritjen e vlerës së tyre është investimi i drejtëpërdrejtë të tregun imobiliar. Faktorë të tjerë, si p.sh. rritja e vlerës së pasurive të paluajtshme nga rivlerësimi kanë pasur një ndikim të papërfillshëm. Në studim identifikohet vetëm një rast, ku subjekti ka deklaruar shtim të vlerës së shtëpisë si rrjedhojë e rivlerësimit të pasurisë së paluajtshme dhe kjo vlerë e përkthyer në % është rreth 0.5%. Ka edhe raste të tjera që vetëm citohen si fakt nga deklaruesit, por pa dhënë shifra konkrete të vlerës së re pas rivlerësimit.

Në shifrat e prezantuara më lart lidhur me ndryshimet në vlerën totale të pasurive të paluajtshme, duhet të merret parasysh fakti që ato nuk përfshijnë fitimet e mundshme të subjekteve deklaruese nga shitblerjet e tyre ose dhënia me qera, të cilat pasqyrohen në kategorinë 'Të ardhurat' më poshtë në këtë kapitull.

*Likuiditetet:* Duke marrë parasysh vlerat fillestare të deklaruara nga 48 gjyqtarët e Gjykatave Administrative në formularët e deklaramit për herë të parë, si dhe duke ndjekur të gjitha deklaramet e viteve pasardhëse lidhur me shtesat ose pakësimet e likuiditeteve, në fund të vitit 2017 rezulton se vlera akumulative e likuiditeteve në bankë është 185,166,115 lekë, ndërsa ajo e likuiditeteve në Cash 103,890,384 lekë, duke përfaqësuar respektivisht 21.9% dhe 12.3% të vlerës totale të të gjitha asetëve të deklaruara.

Vlera e likuiditeteve (e shprehur në lekë) është rritur në mënyrë progresive ndër vite, siç paraqitet në Grafikon 3 më poshtë.

**Grafiku 3: Ndryshimet e vlerës akumulative të likuiditeteve në bankë dhe Cash nga fillimi i detyrës deri në fund të vitit 2017.**



Likuiditetet në bankë janë rritur me rreth 16.7 herë nga deklarimi për herë të parë deri në fund të vitit 2017, ndërsa likuiditetet në Cash janë rritur me gati 23.3 herë për të njëjtën periudhë deklarimi.

Huadhënia është nënkategoria që ka pësuar rritjen më të madhe në kategorinë e aseteve nga deklarimi për herë të parë deri në fund të vitit 2017, me rreth 25.5 herë. Nga të dhënat e analizuar, vihet re një trend në rritje i dhënies së huave nga ana e gjyqtarëve jo vetëm në frekuencë, por dhe në vlerat që qarkullohen, pavarësisht se krahasuar me vlerën totale të interesave private bruto, huadhënia zë një përqindje relativisht të vogël prej vetëm 1.8%.

Më 31.12.2017, nga vlera totale e likuiditeteve në Cash rezultojnë se mesatarisht çdo gjyqtar mban likuiditete Cash në shtëpi rreth 2,2 milionë lekë (2,164,383 lekë). Nëse shumës së likuiditeteve në Cash do t'i shtojmë edhe përqindjen e aseteve të deklaruara në formën e huadhënies, atëherë rezultojnë se një përqindje e konsiderueshme e vlerës totale të aseteve, rreth 14.1% mbahet jashtë sistemit bankar, duke përfaqësuar dhe pjesën më "informale" të pasurisë së deklaruar të këtyre gjyqtarëve.



**Rreth 14.1% e vlerës totale të aseteve të gjyqtarëve të Gjykatave Administrative mbahet në formën e likuiditeteve Cash dhe huadhënies jashtë sistemit bankar.**

Mbajtja e likuiditeve Cash jashtë sistemit bankar konsiderohet në praktikat më të mira ndërkombëtare si një 'flamur i kuq' ose shenjë transaksionesh të dyshimta, çfarë duhet të shtyjë organet përgjegjëse të ndërmarrin një kontroll të plotë administrativ për subjektet e identifikuara.

**Huadhënia:** Nënkatëgoria e huadhënies zë rreth 5% të vlerës totale të likuiditeteve, ose 1.8% të vlerës totale të aseteve që disponojnë në total 48 gjyqtarët e Gjykatave Administrative. Vlera e huadhënies ka ndryshuar nga 600,000 lekë në vitin fillestar deri në 15,286,426 lekë në fund të periudhës së analizuar.

**Pasuri të Luajtshme:** Në të njëjtin trend me nënkategoritë e tjera, edhe pasuritë e luajtshme kanë pësuar rritje me 4.9 herë gjatë viteve të deklarimit. Në deklarimin për herë të parë pasuritë e luajtshme ishin 7,346,352 lekë, ndërsa në fund të vitit 2017 ato kapin shifrën e 36,114,295 lekëve. (Grafiku 4).

**Grafiku 4: Vlera akumulative e pasurive të luajtshme ndër vite, e shprehur në lekë.**



Nga analiza cilësore e deklaratave, në këtë nënkategori përfshihen kryesisht automjetet e subjekteve deklaruese dhe familjarëve të tyre, që zotërohen në një vit të caktuar financiar. Çdo fitim ose humbje nga shitblerja e pasurive të luajtshme reflektohet në kategorinë "Të ardhura", të paraqitura më poshtë në këtë kapitull. Bazuar në sa më lart, mesatarisht në fund të vitit 2017 një gjyqtar ka pasur në pronësi automjet/e në vlerë mesatare 752,381 lekë.

Ndër nënkategoritë e tjera të interesave private që janë deklaruar, është e rëndësishme të theksohet mungesa e deklarimit të **Sendeve me vlerë të veçantë**. Vetëdeklarimet tregojnë se asnjë gjyqtar apo familjar i tyre nuk zotëron sende me vlerë mbi 300,000 lekë, duke ngritur kështu një 'flamur të kuq' drejt vlerësimeve më të detajuara.



Në të gjitha formularët e marrë në analizë nuk ka asnjë deklaram për zotërim të sendeve me vlerë të veçantë mbi 300,000 lekë nga ana e gjyqtarëve të Gjykatave Administrative dhe familjarëve të tyre.

### 1.c. Pasuria sipas institucionit

#### SI NDRYSHON PASURIA BRUTO E GJYQTARËVE SIPAS STRUKTURËS ORGANIZATIVE?

Duke bërë një analizë krahasuese të pasurisë bruto të deklaruar nga gjyqtarët e Gjykatave Administrative të shkallës së parë dhe Gjykatës Administrative të Apelit, në vlerë absolute vërehet ndjeshëm se Gjykata Administrative e Apelit zë 44% të vlerës totale të pasurisë. Në një përqindje tepër më të ulët renditet Gjykata Administrative Tiranë, me 18% në raport me vlerën totale të pasurisë bruto, ndonëse ajo ka një numër më të lartë gjyqtarësh në strukturën e vet organizative se Gjykata Administrative e Apelit.

Gjykatat Administrative të rretheve Durrës, Korçë, Gjirokastrë, Shkodër dhe Vlorë zënë mesatarisht secila 5-12% të vlerës totale të pasurisë.

Pra, rreth 62% e vlerës totale të pasurisë së 48 gjyqtarëve, objekt i këtij studimi, është përqëndruar vetëm në dy njësi: Gjykata Administrative e Apelit dhe Gjykata Administrative pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, pikërisht aty ku është përqëndruar dhe numri më i madh i gjyqtarëve. Rrjedhimisht kjo renditje e vlerës së pasurisë bruto ndikohet në raport të drejtë nga numri i gjyqtarëve, që do të thotë se 62% e pasurisë bruto është në pronësi të 58% të numrit të përgjithshëm të gjyqtarëve të Gjykatave Administrative.

Analiza u thellua në listimin e vlerës mesatare të pasurisë bruto për një gjyqtar. Nëse si bazë krahasuese merret pasuria mesatare deri me datë 31.12.2017 e gjyqtarëve në funksion, renditja e re rezulton paksa ndryshe nga ajo e paraqitur më lart. Ashtu siç tregojnë dhe të dhënat e Tabelës 6, në vend të parë për nga pasuria renditen gjyqtarët e Gjykatës Administrative të Apelit me pasuri mesatare për gjyqtar në vlerën 28,329,576 lekë; ndërsa gjyqtarët e Gjykatës Administrative Tiranë janë ata me më pak pasuri në pronësi, me mesatarisht 10,299,363 lekë për gjyqtar.

**Tabela 7: Pasuria e gjyqtarëve të Gjykatave Administrative sipas ndarjes institucionale:**

Institucioni	Pasuria bruto 31.12.2017	% e pasurisë totale	Nr. Gjyqtarëve	Pasuria mesatare
Gjykata Administrative e Apelit	368.286.827	44%	13	28.329.756
Gjykata Administrative Tiranë	154.490.444	18%	15	10.299.363
Gjykata Administrative Durrës	46.276.036	5%	4	11.569.009
Gjykata Administrative Korçë	40.873.496	5%	3	13.624.499
Gjykata Administrative Gjirokastrë	86.064.043	10%	7	12.294.863
Gjykata Administrative Shkodër	49.087.266	6%	2	24.543.633
Gjykata Administrative Vlorë	99.382.635	12%	4	24.845.659
<b>Total</b>	<b>844.460.748</b>	<b>100%</b>	<b>48</b>	<b>N/A</b>

Në vlerësimin e të dhënave të pasurisë së gjyqtarëve dhe familjarëve të tyre, nga pasuria e tyre fillestare deri në gjendjen e pasurisë me datë 31.12.2017, rezulton se në listën e pesë gjyqtarëve që kanë pasur rritjen më të madhe të pasurisë janë: 4 gjyqtarë të Gjykatës Administrative të Apelit dhe një gjyqtar i Gjykatës Administrative të rrethit Vlorë.

**Tabela 8: Shtesa mesatare vjetore e pasurisë sipas institucioneve:**

Institucioni	Nr. i gjyqtarëve	Shtesa mesatare vjetore për gjyqtar (në lekë)
Gjykata Administrative e Apelit	13	1.876.349
Gjykata Administrative Vlorë	4	1.850.057
Gjykata Administrative Shkodër	2	1.522.377
Gjykata Administrative Korçë	3	1.072.157
Gjykata Administrative Tiranë	15	750.915
Gjykata Administrative Gjirokastrë	7	749.690
Gjykata Administrative Durrës	4	396.059

## 2. DETYRIMET

Përveç aseteve të krijuara gjatë periudhës së deklaramit të pasurisë, gjyqtarët kanë krijuar dhe detyrime financiare ndaj institucioneve financiare, personave të lidhur si dhe ndaj kompanive të ndryshme, kryesisht atyre të ndërtimit.

Kategoria e detyrimeve përfshin këto nënkategori:

- Kredi bankare;
- Huamarrje ndaj personave të tretë;
- Detyrime ndaj shoqërive të ndërtimit;
- Detyrime të tjera.

Nga analizimi i deklaratave vihet re se detyrimet janë një nga mënyrat e përdorura gjerësisht për financimin dhe investimin në pasuri të paluajtshme apo të luajtshme nga ana e subjekteve deklarues dhe familjarëve të tyre. Në më pak raste evidentohet se këto detyrime janë përdorur për të mbuluar shpenzime shkollimi, apo shpenzime të llojit konsumator.

### 2.a. Totali i Detyrimeve

#### SA ËSHTË TOTALI I DETYRIMEVE NGA FILLIMI I DETYRËS DERI NË FUND TË VITIT 2017?

Në Tabelën 9 pasqyrohen vlerat në lekë të detyrimeve të deklaruara nga gjyqtarët gjatë viteve të deklaramit, të ndara sipas katër nënkategorive kryesore të tyre.

**Tabela 9: Vlerat në lekë të detyrimeve sipas nënkategorive**


Llojet e detyrimeve	Shuma në Lek
Kredi Bankare	160.621.276
Detyrime ndaj shoqërive të ndërtimit	95.429.745
Huamarrje	83.348.090
Detyrime të tjera	1.138.426
<b>Total</b>	<b>340.537.537</b>

Siç tregojnë të dhënat e paraqitura në Tabelën 9, vlerat e detyrimeve të deklaruara nga gjyqtarët e Administratives për secilën nënkategori nuk paraqesin një model lehtësisht të parashikueshëm.

Megjithatë, vlerat e detyrimeve janë të konsiderueshme, duke arritur shumën 340,537,537 lekë në fund të periudhës deklaruese (31.12.2017).

Nga kjo shumë, siç tregohet dhe në Grafikon 5, pjesën më të madhe të detyrimeve e zënë kreditë bankare me 47.2% të vlerës totale, detyrimet e mbetura pa shlyer ndaj shoqërive të ndërtimit janë në masën 28%, ndërsa rreth 24.5% e vlerës i përket detyrimeve ndaj personave të afërm në formë huamarrjeje dhe një shumë minimale prej 0.3% i përket “detyrimeve të tjera”.

**Grafiku 5: Raporti në përqindje mes nënkategorive të ndryshme të detyrimeve.**



Bazuar në praktikat më të mira ndërkombëtare, detyrimet e larta jashtë sistemit bankar, të tilla si huamarrja ndaj personave të tretë dhe detyrimet e pashlyera ndaj kompanive të ndërtimit konsiderohen gjerësisht si indikatorë transaksionesh të dyshimta të rrjedhjes së parasë në hyrje dhe identifikohen në manulet për procedimin dhe analizimin e deklaratave të pasurisë si ‘flamuj të kuq’. Shumat e larta të huamarrjes jashtë sistemit bankar (24.5%) dhe detyrimet ndaj kompanive të ndërtimit (28%) janë tregues i nevojës për një hetim më të detajuar të deklaratave nga ana e institucioneve monitoruese të sistemit.



**Rreth 53% e vlerës së detyrimeve të gjyqtarëve të Gjykatave Administrative lidhet me huamarrje dhe detyrime ndaj personave të tretë dhe kompanive të ndërtimit.**



Nga numri i përgjithshëm prej 48 gjyqtarësh rezultojnë se 43 prej tyre ose rreth 90% e gjyqtarëve të Gjykatave Administrative kanë deklaruar detyrime në formë kredie bankare, huamarrje, detyrime ndaj shoqërive të ndërtimit apo detyrime të tjera gjatë periudhës së deklarimit të pasurisë në ILDKPKI.

Për të njëjtën periudhë rezultojnë se rreth 29% e gjyqtarëve që rezultojnë me detyrime në sistemin bankar, kanë marrë të paktën një herë kredi gjatë periudhës deklaruese; 27% e tyre kanë marrë 2-3 kredi gjatë periudhës deklaruese dhe 17% e tyre kanë marrë 4-8 kredi.

Në vijim të kësaj mbi detyrimet rezultojnë se 44% e gjyqtarëve të Gjykatave Administrative ose 21 nga 48 gjyqtarë, *ka marrë të paktën një herë* hua nga të afërm apo persona fizikë gjatë periudhës deklaruese.

42% e gjyqtarëve rezultojnë të kenë detyrime ndaj shoqërive të ndërtimit për kontratat e sipërmarrjes që kanë lidhur ndër vite, të paktën një herë gjatë periudhës deklaruese.

## 2.b. Detyrimet e pashlyera

### SA ËSHTË VLERA E DETYRIMEVE TË PASHLYERA NË FUND TË VITIT 2017?

Më sipër është identifikuar totali i detyrimeve të deklaruara nga gjyqtarët dhe familjarët e tyre ndër vite. Kjo vlerë është 340,537,537 lekë dhe përmbledh të gjitha detyrimet e deklaruara në nënkategoritë e ndryshme, por është e rëndësishme që të identifikohet edhe shuma e pagesës/kthimit të detyrimit, e paguar në formë kësti përgjatë viteve. Për këtë qëllim, siç shpjegohet dhe në kapitullin e Metodologjisë, të gjitha pagesat e detyrimeve janë regjistruar si nënkategori e veçantë në kategorinë e “Shpenzimeve” në databazën kryesore (referoju Aneksit I të këtij raporti ‘Kodifikimi i kategorive dhe nënkategorive’).

Në tabelën 10 pasqyrohet shlyerja e detyrimeve përkatësisht ndaj bankave, shoqërive të ndërtimit dhe ndaj personave të tretë (huadhënësve):

**Tabela 10: Vlera në lekë e pagesave të kësteve të detyrimeve financiare përgjatë viteve**

Shlyerja e detyrimeve	Shuma në Lek
Pagesë kesti kredie	114.967.542
Pagese kesti huaje	55.274.160
Pagese shoqërisë ndërtimit	41.822.696
<b>Total</b>	<b>212.064.398</b>

Me qëllim përlllogaritjen e shumës së detyrimit të pashlyer deri në fund të vitit 2017 është përdorur formula e mëposhtme, e cila përlllogarit vlerën e diferencës mes totalit të detyrimeve me shlyerjet totale ndër vite:



Në këtë mënyrë, shumës së detyrimeve të akumuluar ndër vite me vlerë 340,537,537 lekë i zbriten pagesat e kësteve (pagesë kësti kredie, kthim huaje dhe shlyerje ndaj shoqërive të ndërtimit) në shumën 212,064,398 lekë. Rezultati 128,473,138 lekë përfaqëson gjendjen e pashlyer të detyrimit në fund të vitit 2017. (Tabela 11).

**Tabela 11: Vlera e detyrimeve të pashlyera në fund të vitit 2017 e shprehur në lekë.**

Shuma totale e detyrimeve të deklaruara gjatë gjithë periudhës së deklarimit (a)	Totali i pagesave për shlyerje detyrimesh gjatë gjithë periudhës (b)	Gjendja e detyrimit të pashlyer në fund të vitit 2017 (a-b)
340,537,537 lekë	212,064,398 lekë	128,473,138 lekë

## 2.c. Raporti pasuri bruto/detyrime sipas institucioneve

### SA KA NDIKUAR SHTIMI I DETYRIMEVE FINANCIARE NË RRIJTJEN E PASURISË MESATARE BRUTO SIPAS INSTITUCIONEVE?

Detyrimet vazhdojnë të jenë trend në rrethin e zyrtarëve të gjyqësorit, si një mjet financiar i rëndësishëm në shtimin e pasurisë së tyre. Në tabelën e mëposhtme (Tabela 12) është pasqyruar për secilën Gjykatë Administrative raporti mes pasurisë mesatare të shtuar gjatë ushtrimit të funksionit dhe detyrimeve financiare mesatare, që secili gjyqtar ka marrë gjatë së njëjtës periudhë. Qëllimi i kësaj tablele është që të identifikojë sa përqind e pasurisë së shtuar finanohet nga detyrimet ndaj

institucioneve financiare apo palëve të treta.

**Tabela 12: Raporti mes pasurisë mesatare të shtuar dhe detyrimeve financiare mesatare gjatë ushtrimit të funksionit në rang institucioni, e shprehur në përqindje**

Institucioni	Shtesa e pasurisë	Detyrimet financiare	Raporti i shtimit të pasurisë me detyrimet
Gjykata Administrative Vlorë	87,286,163	82,569,713	95%
Gjykata Administrative Durrës	20,580,005	14,033,020	68%
Gjykata Administrative Tiranë	143,370,291	76,187,194	53%
Gjykata Administrative Shkodër	42,626,566	16,351,720	38%
Gjykata Administrative e Apelit	340,863,967	107,283,544	31%
Gjykata Administrative Korçë	39,953,496	10,178,000	25%
Gjykata Administrative Gjirokastrë	72,335,934	16,681,412	23%
<b>Total</b>	<b>747,016,423</b>	<b>323,284,603</b>	<b>43%</b>

Rezultatet ngrejnë “flamuj të kuq” për dy ekstremitetet, përqindja shumë e lartë dhe ajo shumë e ulët. Në rastin e parë, institucionet përgjegjëse për hetimin administrativ kanë për detyrë të identifikojnë arsyen e marrjes së kredive në shumën të konsiderueshme dhe pse ato nuk janë investuar në pasuri të paluajtshme apo asetë të tjera (rasti i rrethit gjyqësor Vlorë, ku raporti i shumës mesatare të detyrimeve me pasurinë mesatare bruto është 95%). Nga ana tjetër, përqindja e ulët duhet të nxisë hetime më të detajuara për të gjetur burimet alternative që gjyqtarët kanë përdorur për pasurinë e shtuara dhe ligjshmërinë e këtyre burimeve.

Duke arsyetuar mbi këtë raport mund të thuhet se detyrimet financiare të deklaruara përdoren për investime në pasuri të paluajtshme dhe/apo për blerje automjetesh, që do të thotë se një kredi bankare nuk mund të jetë përdorur për të çelur një llogari bankare apo për të shtuar gjendjen e parave Cash. Nën këtë arsyetim, raporti mes detyrimeve financiare dhe shtimit të pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme ngushtohet ndjeshëm, siç tregohet dhe në tabelën më poshtë. Rezulton që Gjykata Administrative Vlorë dhe ajo e Durrësit kanë një përqindje shumë të lartë të detyrimeve në raport me pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme, përkatësisht 141% dhe 114%, duke ngritur dyshime dhe pikëpyetje mbi destinacionin e kredive bankare që disbursohen nga bankat e nivelit të dytë ndaj këtyre subjekteve dhe familjarëve të tyre.

### 3. PASURIA NETO

#### SI KA NDRYSHUAR PASURIA NETO NGA FILLIMI I DETYRËS DERI NË VITIN 2017?

Pasuria neto përcakton diferencën mes asetëve, pasurisë bruto të prezantuar në pikën 1 të këtij kapitulli dhe vlerës së detyrimeve të pashlyera në fund të periudhës së deklarimit të përlogaritur më lart.

Kjo formulë mundëson përlogaritjen e vlerës akumulative të pasurisë neto që gjyqtarët zotërojnë në fund të vitit 2017 (Tabela 13), por dhe rritjen e pasurisë neto gjatë periudhës së deklarimit të marrë në analizë.

**Tabela 13: Pasuria neto e gjyqtarëve të Gjykatave Administrative në fund të vitit 2017 e shprehur në lekë**

Pasuria bruto deri më datë 31.12.2017 (a)	Detyrime të pashlyera deri më datë 31.12.2017 (b)	Pasuria neto më datë 31.12.2017 (a-b)
844,460,748 lekë	128,473,138 lekë	715,987,609 lekë

Pra, gjendja e pasurisë neto me datë 31.12.2017 për 48 gjyqtarët është 715,987,609 lekë.

Njëkohësisht, duke iu rikthyer tabelës nr. 3, ku pasqyrohet rritja e pasurisë nga fillimi i detyrës deri me datë 31.12.2017 dhe vlerës së detyrimeve të pashlyera deri me datë 31.12.2017, mund të llogaritet sa është **rritja e pasurisë neto**.

**Shtesa e Pasurisë Neto** është diferenca mes vlerës së shtuar të pasurisë bruto në shumën 747,016,423 lekë dhe detyrimeve të pashlyera në shumën 128,473,138 lekë, e cila rezulton të jetë 618,543,285 lekë.

**Shtesa e pasurisë neto për periudhën e deklarimit për numrin e përgjithshëm të gjyqtarëve nga fillimi i deklarimit deri në fund të vitit 2017 është 618,543,285 lekë.**

### 4. TË ARDHURAT

Kategoria e të ardhurave të zyrtarëve që janë subjekt i deklarimit të pasurisë, përbëhet nga këto nënkategori kryesore:

- Paga nga funksioni;
- Paga e familjarëve;

- Shpërblime neto;
- Të ardhura nga biznesi;
- Të ardhura nga qiradhënia;
- Të ardhura nga mësimdhënia (vetëm për gjyqtarët, jo familjarët);
- Dhuratat (në cash ose në forma të tjera);
- Të ardhura nga shitja e pasurive të paluajjtshme;
- Të ardhura nga shitja e pasurive të luajjtshme;
- Të ardhura të tjera (për të ardhurat që nuk përfshihen në kategoritë e mësipërme).

#### 4.a. Totali i të ardhurave

### SA ËSHTË TOTALI I TË ARDHURAVE NGA FILLIMI I DETYRËS DERI NË FUND TË VITIT 2017?

Totali i të ardhurave të deklaruara nga vetë gjyqtarët dhe familjarët e tyre në të gjitha deklaratat e interesave private Periodike/Vjetore arrin në një vlerë totale prej 1,329,296,377 lekësh.

Megjithatë, ndryshe nga përllogaritja e vlerës së aseteve të deklaruara, e cila është **akumulative** nga viti i parë i deklaramit (Deklaratat e Interesave Private Para Fillimit të Detyrës) deri në deklaratën e fundit (Deklarata Periodike/Vjetore 2017), në përllogaritjen e të ardhurave është marrë në konsideratë baza ligjore për plotësimin e rubrikës së të ardhurave nga subjektet deklarues. Në nenin 5/1 të Ligjit nr.9049, parashikohet që në deklarinimin e të ardhurave për herë të parë duhet të deklarohet: *“angazhimet në veprimtari private me qëllim fitimi ose çdo lloj veprimtarie që krijon të ardhura, që ekzistojnë në datën e fillimit të punës, përfshirë çdo lloj të ardhure të krijuar nga këto angazhime ose veprimtari, nga data 1 janar deri në datën e fillimit të punës të vitit të deklaramit.”*

Për këtë arsye, në trajtimin e të ardhurave si burim financiar për krijimin e pasurisë së deklaruar janë përllogaritur vetëm të ardhurat e krijuara nga subjektet deklaruese dhe familjarët e tyre pas datës së emërimit. Pra, në analizë do të merren për bazë të ardhurat nga viti 2004 deri në vitin 2017, të vetëdeklaruara në llojin e deklaramit Periodik/Vjetor, ashtu siç ato paraqiten në Tabelën 14.

**Tabela 14: Vlera e të ardhurave të deklaruara për secilin vit kalendarik 2004-2017**

Viti	Të ardhurat në Lek
2004	40.321.460
2005	42.621.039
2006	59.942.432

2007	67.908.659
2008	85.665.761
2009	81.666.972
2010	97.359.993
2011	98.688.447
2012	109.818.363
2013	106.970.722
2014	111.524.790
2015	135.635.410
2016	159.606.597
2017	131.565.734
<b>Total</b>	<b>1.329.296.377</b>

Siç shihet nga Tabela 14, shuma totale e të ardhurave të deklaruar nga 48 subjektet për periudhën 2004-2017 është 1,329,296,377 lekë. Shuma vjetore e të ardhurave të deklaruar nga ana e gjyqtarëve ka qenë në rritje të vazhdueshme vit pas viti, e cila pjesërisht justifikohet me shtimin e numrit të gjyqtarëve gjatë periudhës 2003-2017 në Gjykatat Administrative.

#### 4.b. Burimi i të ardhurave

### SI JANË TË NDARA KËTO TË ARDHURA SIPAS NËNKATEGORIVE?

Duke qenë se në totalin e saj, rritja e pasurisë së gjyqtarëve nuk justifikohet nga të ardhurat e përftuara nga paga/shpërblimet, BIRN analizoi në mënyrë të detajuar burimet e të ardhurave të deklaruar nga këta gjyqtarë, në mënyrë që të identifikonte më qartë strukturën e kësaj kategorie.

Nënkategoritë që përbëjnë totalin e vlerës së të ardhurave të deklaruar nga gjyqtarët në mënyrë përmbledhëse janë klasifikuar në: Dhurata në Cash; Mësimdhënia; Paga e familjarëve; Paga nga funksioni; Shpërblime neto; Të ardhura nga biznesi; Të ardhura nga Qiradhënia; Të ardhura nga shitja e pasurive të luajtshme; Të ardhura nga shitja e pasurive të paluajtshme; dhe Të ardhura të tjera. Në mënyrë që të diferencohet burimi i të ardhurave, baza e të dhënave e ngritur për qëllim të këtij studimi ka identifikuar secilën nga këto nënkategori, duke i dhënë dhe kode të ndryshme (referoju Aneksit I të këtij raporti).

Raporti ndërmjet këtyre nënkategorive, i paraqitur në vlerë në Lek dhe në përqindje, për të gjithë subjektet deklarues është prezantuar në Tabelën 15 më poshtë.

**Tabela 15: Vlera totale në lekë për secilën nënkategori të ardhurash dhe raporti mes tyre**

Nënkategoritë e të ardhurave	Shuma në Lek	Raporti si % e shumës totale
Paga dhe shpërblime nga funksioni	606.707.630	45,6%
Mësimdhënia	16.020.615	1,2%
Paga e familjarëve	338.880.130	25,5%
Dhurata në Cash	17.552.713	1,3%
Të ardhura nga biznesi	97.501.148	7,3%
Të ardhura nga Qira	64.555.255	4,9%
Të ardhura nga shitja e pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme	76.269.428	5,7%
Të ardhura të tjera	111.809.459	8,4%
<b>Totali</b>	<b>1.329.296.377</b>	<b>100%</b>

Siç pasqyrohet nga të dhënat e prezantuara në Tabelën 15, rreth 46.8% e të ardhurave të deklaruara sigurohen në mënyrë të drejtpërdrejtë nga vetë gjyqtari përmes pagës dhe shpërblimeve nga ushtrimi i funksionit, si dhe nga mësimdhënia, ndërsa të ardhurat në formë pagash nga familjarët zënë rreth 25.5% të vlerës totale të të ardhurave.

Nënkategoria “Dhurata në Cash” përmbledh të gjitha rastet e deklaruara të dhuratave në Cash ose në forma të tjera asetesh si prona apo autovetura, kur janë deklaruar me vlerë nga subjekti deklarues - këtu nuk përfshihen rastet e dhurimeve të pasurive të paluajtshme apo të luajtshme për të cilat nuk është shënuar një vlerë. Ky tregues është një “flamur i kuq” dhe duhet të jetë në vëmendje të organeve të kontrollit, pasi konkretisht ky zë arrin në 17,552,713 lekë dhe zë rreth 1.3% të totalit të të ardhurave. Zërat e tjerë të kategorisë “Të Ardhura” zënë një përqindje të vogël në krahasim me vlerën totale.



**Rreth 1.3% e të ardhurave të gjyqtarëve në Gjykatat Administrative buron nga dhuratat, duke kapur vlerën mbi 17.5 milionë lekë.**

Nga analiza e mësipërme rezulton se përveç të ardhurave nga pagat, një pjesë e mirë e të ardhurave të gjyqtarëve burojnë nga biznesi, shitja e pasurive të paluajtshme dhe të luajtshme si dhe qiradhënia. Të

ardhurat e larta nga këto burime konsiderohen në praktikën ndërkombëtare të kontrollit të pasurisë si 'flamuj të kuq' dhe sinjale për organin që administron kontrollin e pasurisë për analiza më të thelluara të subjektit deklarues dhe familjarëve të tij.



**Rreth 18% e të ardhurave të gjyqtarëve në Gjykatat Administrative buron nga biznesi, shitblerja e pasurive të luajtshme/paluajtshme dhe qiradhënia.**

## 5. SHPENZIMET

Pasi kemi marrë në analizë të ardhurat e gjyqtarëve që përfshihen në kategorinë e transaksioneve të parasë në hyrje, është e rëndësishme të analizohet dhe struktura e shpenzimeve të tyre, që klasifikohet në kategorinë e rrjedhjes së parasë në dalje.

Në kategorinë e shpenzimeve, përfshihen këto nënkategori kryesore:

- Pagesë kësti kredie;
- Pagesë kësti huaje;
- Pagesë e kryer ndaj shoqërisë së ndërtimit ku ka pasur detyrime;
- Shpenzime shkollimi;
- Shpenzime të tjera (të cilat nuk përfshihen në kategoritë e mësipërme).

Duke vlerësuar me kujdes mënyrën e plotësimit të rubrikës së detyrimeve u konstatua se në rastet e kredive bankare, subjektet e deklarimit pasqyrojnë pagesën e kësteve që paguajnë në bazë mujore apo vjetore. Në asnjë rast, ky këst nuk pasqyrohet i ndarë në principal+interes, por jepet i plotë. Në këto kushte është e pamundur të regjistrohet si zë më vehte shpenzimi për normë interesi dhe pakësimi i principalit të kredisë si pakësim detyrimi. Për këtë arsye, është parashikuar dhe në metodologji që vetëdeklarimet për pagesë këstesh janë trajtuar si pakësim detyrimi dhe janë përfshirë në seksionin "2.b. Detyrimet e pashlyera" të prezantuar më lart.

Kategoria e shpenzimeve ka një specifikë të veçantë në formularin e deklarimit. Detyrimi ligjor për deklarimin e "shpenzimeve të deklarueshme" ka hyrë në fuqi nga viti 2014, pas amendimit të fundit ligjor që iu bë ligjit nr.9049, referuar nenit 1 pika 7 të këtij ligji. Por edhe pas këtij ndryshimi ligjor, në

.....  
• "Shpenzim i deklarueshëm" është tërësia monetare, e paguar për arsim, mjekim shëndetësor, pushime, arredim, si dhe të tjera shpenzime të këtij lloji, të kryera nga subjekti deklarues.



formatin e deklaratës “Deklaratë e Interesave Private Periodike/Vjetore” shpenzimet e deklarueshme janë klasifikuar si e dhënë konfidenciale dhe për këtë arsye nuk ofrohen për publikim.

Kështu pra, rezulton që të dhënat për shpenzime të tjera klasifikohen si më poshtë:

Nënkategori të Shpenzimeve	Shuma në Lek
Shpenzime shkollimi	5.469.678
Shpenzime të tjera	22.906.905
<b>Totali</b>	<b>28.376.583</b>

Nga të dhënat që ofrojnë formularët e deklarimit rezulton se nga 48 gjyqtarët, objekt i këtij studimi, vetëm 11 prej tyre kanë deklaruar shpenzime shkollimi në një total prej 5,469,678 lekësh për periudhën e marrë në analizë. Megjithatë, mbetet e zbuluar dhe jo e qartë analiza në lidhje me shpenzimet e subjekteve deklaruese, për sa kohë që rubrika e Shpenzimeve të Deklarueshme është konfidenciale dhe nuk ofrohet për publikim.

Konkretisht, analizimi i 650 deklaratave të këtij studimi nxjerr në pah mungesën e deklarimeve të gjyqtarëve për shpenzime jetike, shkollim, trajtime shëndetësore, shpenzime udhëtimi, etj., duke theksuar nevojën e përfshirjes së të gjitha shpenzimeve në deklaratat e interesave private, si një mundësi më e mirë drejt nxitjes së transparencës. Nga 48 subjekte, vetëm një prej tyre ka deklaruar shpenzime konsumi familjar, në vetëm 3 prej 14 deklarimeve që ka dorëzuar në ILDKPKI. Në asnjë prej deklaratave të tjera nuk ka të dhëna për shpenzimet e konsumit jetik.



**Vetëm 3 nga 650 deklaratat e analizuarra përfshijnë në kategorinë e shpenzimeve kosto të lidhura me konsumin jetik.**

Duke përmbledhur të dhënat që përmban formulari i deklarimit Periodik/Vjetor në lidhje me shpenzimet (pavarësisht interpretimit që u bë në seksionin “2.b. Detyrimet e pashlyera” për pagesat e kësteve), rezulton informacioni i Tabelës nr.17, ku nënkategoritë e shpenzimeve janë trajtuar si fluks dalës i parasë për periudhën e ushtrimit të detyrës. Kolona e fundit e kësaj tablele paraqet raportin e secilës nënkategori kundrejt vlerës totale.

**Tabela 17: Vlera në lekë e shpenzimeve totale, e ndarë sipas nënkategorive dhe raporti i tyre në Përqindje**

Shpenzimet	Shuma në Lek	Raporti në %
Pagese kesti huaje	55.274.160	23%
Pagesë kesti kredie	114.967.542	48%
Pagese shoqërisë ndertimit	41.822.696	17%
Shpenzime shkollimi	5.469.678	2%
Shpenzime të tjera	22.906.905	10%
<b>Total</b>	<b>240.440.981</b>	<b>100%</b>


Të dhënat e mësipërme tregojnë se pjesa më e madhe e shpenzimeve të deklaruar lidhen me pagesat e këstëve të huave, kredive dhe detyrimeve ndaj shoqërive të ndërtimit, duke vënë në pah dhe njëherë mundësinë e deklarimeve të nënkategorive të tjera të shpenzimeve nga ana e subjekteve deklaruese.



**Rreth 48% e shumës së shpenzimeve të deklaruar të gjyqtarëve mbulon këstet e kredive bankare.**

## 6. TË ARDHURAT NETO

Të ardhurat neto të 48 gjyqtarëve janë përllogaritur për periudhën 2004-2017, si diferencë mes të ardhurave totale me shpenzimet e deklaruar, të përllogaritura më lart sipas formulës që vijon:



Të ardhurat neto për 48 gjyqtarë dhe familjarët e tyre për periudhën 2004-2017 janë në shumën 1,088,855,396 lekë.

Duhet theksuar se vetëm në tre raste (deklarata vjetore), në zërin e shpenzimeve të përlogaritura më sipër janë përfshirë shpenzimet e konsumit jetik. Nëqoftëse shpenzimet e konsumit jetik do të përfshihen në përlogaritje, të ardhurat neto do të rezultojnë ndjeshëm më të ulëta.

## 7. KONTROLLI ARITMETIK DHE LOGJIK

### SA ËSHTË PASURIA E PAJUSTIFIKUAR ME BURIME FINANCIARE SIPAS REZULTATIT TË KONTROLLIT ARITMETIK DHE LOGJIK?

Nga analiza e strukturës së aseteve dhe detyrimeve nga njëra anë dhe të ardhurave dhe shpenzimeve nga ana tjetër, të vetëdeklaruar nga 48 gjyqtarë të Gjykatave Administrative gjatë periudhës 2004-2017 pranë ILDKPKI, vërehen një numër trendesh në transaksione të identifikuar si të dyshimta ose 'flamuj të kuq', bazuar në praktikën më të mira ndërkombëtare në këtë fushë.

Në këtë kontekst, BIRN ndërmori kontrollin aritmetik-logjik të plotë të deklaratave të pasurisë së këtyre gjyqtarëve për periudhën 2004 – 2017. Kjo analizë u realizua bazuar në të dhënat e deklaratave të subjekteve si dhe ato të plotësuara nga familjarët e tyre.

Në bazë të nenit 25 të ligjit nr. 9049 i ndryshuar, *"Kontrolli aritmetik dhe logjik kryhet për çdo deklaram, për të vërtetuar saktësinë e vlerësimit të pasurisë së deklaruar, saktësinë e burimeve financiare të deklaruar dhe mjaftueshmërinë e mbulimit të pasurive nga burime të deklaruar"*.

Ky kontroll dokumentohet në Fletën e Kontrollit, në të cilin janë pasqyruar të dhënat e vetëdeklaruar nga zyrtari dhe familjarët e tij, të organizuara në dy pasqyra financiare: asetet neto dhe të ardhurat neto. Pas plotësimit dhe përpunimit të këtyre të dhënave, gjenerohet një informacion lidhur me faktin nëse: *të ardhurat neto të periudhës justifikojnë apo jo ndryshimin e asetëve neto për periudhën deklaruese.*

Pavarësisht detyrimit ligjor që ka ILDKPKI për të ushtruar kontrollin aritmetik dhe logjik për çdo deklaratë që dorëzohet, BIRN ka kryer kontrollin Aritmetik dhe Logjik vetëm për deklaratat e intereseve private Periodike/Vjetore. Pra, është analizuar si ka ndryshuar pasuria e gjyqtarëve nga momenti që ata janë emëruar në një funksion publik dhe janë bërë subjekte të ligjit të deklarimit, deri me datë

31.12.2017.

Formula për ndërtimin e një flete kontrolli Aritmetik dhe Logjik paraqitet si më poshtë vijon:

***Ndryshimi i Aseteve Neto = Ndryshimi i Aseteve Bruto – Detyrime***

***Të Ardhura Neto = Të ardhurat totale – Shpenzime***

***Nëse diferenca mes “Të Ardhurave Neto” dhe “Ndryshimit të Aseteve Neto” del me vlerë negative, atëherë ajo konsiderohet indicie që pasuria e krijuar gjatë periudhës së deklarimit nuk mund të justifikohet me burimet financiare të deklaruara.***

Duke qenë se kontrolli aritmetik dhe logjik duhet të kryhet për secilën periudhë deklaruese, pra për secilën deklaratë individuale, duke eliminuar vitin fillestar të deklarimit (Deklarata e Interesave Private Para Fillimit të Detyrës), kontrolli aritmetik dhe logjik është kryer për 602 deklarata Periodike/Vjetore të gjyqtarëve.

Nga përmbledhja e të dhënave të kontrollit aritmetik dhe logjik të 602 deklaratave Periodike/Vjetore rezulton se 55 deklarata ose 9.1% e tyre janë me probleme, duke qenë se shtesa e asetëve neto nuk justifikohet me të ardhurat neto.



**Rreth 9.1% e deklaratave Periodike/Vjetore të gjyqtarëve të Gjykatave Administrative dështojnë gjatë kontrollit aritmetik dhe logjik.**

Në mënyrë më të detajuar, numri i deklaratave që nuk justifikojnë pasurinë brenda vitit kalendarik, sipas institucioneve përkatëse prezantohet në Tabelën 18.

**Tabela 18: Numri i deklaratave që nuk justifikojnë pasurinë, sipas Kontrollit Aritmetik dhe Logjik**

Institucioni	Numri i deklaratave	KAL me probleme	% e deklaratave me probleme
Gjykata Administrative Durrës	44	2	5%
Gjykata Administrative e Apelit	181	21	12%
Gjykata Administrative Gjirokastrë	90	10	11%
Gjykata Administrative Korçë	37	2	5%

Gjykata Administrative Shkodër	28	1	4%
Gjykata Administrative Tiranë	182	16	9%
Gjykata Administrative Vlorë	40	3	8%
<b>Total</b>	<b>602</b>	<b>55</b>	<b>9%</b>


Nga 48 gjyqtarë- objekt i këtij studimi rezultojnë se vetëm 17 prej tyre rezultojnë pa diferenca negative nga kontrolli aritmetik dhe logjik. Nga ana tjetër, 31 gjyqtarë ose 65% e totalit të subjekteve të këtij studimi rezultojnë se kanë pasur të paktën në një vit të karrierës së tyre diferenca të pajustificuara midis pasurisë së krijuar dhe burimeve financiare të deklaruara.



**Mbi 65% e gjyqtarëve të Gjykatave Administrative nuk e justifikojnë pasurinë, të paktën në një vit deklarues.**

Nga numri i përgjithshëm i gjyqtarëve të Gjykatave Administrative që kanë rezultuar me probleme gjatë kontrollit Aritmetik dhe Logjik, bazuar në të dhënat e vetëdeklaruara, rezultojnë se 15 gjyqtarë ose 48% e tyre kanë 2-5 deklarata të pajustificuara gjatë gjithë periudhës deklaruese, ndërsa 16 gjyqtarë ose rreth 52% e tyre kanë vetëm një deklaratë të pajustificuar (Grafiku 6).

**Grafiku 6: Numri i gjyqtarëve të ndarë sipas deklaratave të pajustificuara në 14 vitet e deklarimit të pasurisë.**



## SA ËSHTË PASURIA E PAJUSTIFIKUAR ME BURIME FINANCIARE NËSE ZBRESIM SHPENZIMET E KONSUMIT JETIK SIPAS INSTAT?

Shpenzimet konsiderohen një e dhënë personale dhe klasifikohen në kategorinë e të dhënave konfidenciale në formularin e vetëdeklarimit. Për këtë arsye, ILDKPKI përdor mesataren vjetore të konsumit jetik për një familje, sipas Institutit të Statistikave- INSTAT në praktikën e saj të kontrollit aritmetik dhe logjik. Në këto kushte, BIRN i është referuar të dhënave që publikon Instituti i Statistikave në Shqipëri lidhur me konsumin mesatar vjetor për familje. Publikimi më i fundit i INSTAT lidhur me konsumin familjar në Shqipëri është Anketa e Buxhetit të Familjes, një vërtetim statistikor që kryhet pranë njësive ekonomike familjare (NjEF).

Referuar botimeve nga INSTAT në faqen zyrtare në ëeb, për buxhetin e familjes gjendet informacion vetëm për vitin 2006, 2014, 2015, 2016 dhe 2017. Konsumi mesatar mujor ka pësuar rritje në këto vite nga 69,383 lekë (në vitin 2006) deri në 73,400 lekë (në vitin 2017). Si bazë referuese është marrë konsumi mesatar mujor për familje i vitit 2006 (69,383 lekë), dhe duke iu rikthyer sërish kontrollit aritmetik dhe logjik për secilën deklaratë periodike/vjetore, analiza ofron të tjera rezultate. Të dhënat e plota mbi konsumin mesatar mujor dhe vjetor sipas INSTAT-it pasqyrohet në Aneksin nr.3.

Pra, nëse secilës deklaratë periodike/vjetore i shtohen kostot vjetore<sup>2</sup> mesatare të jetesës për familje sipas INSTAT-it, vlera e të ardhurave neto zvogëlohet, duke ndikuar në rritjen e pasurisë së pajustificuar. Pavarësisht se konsumi mesatar vjetor (832,596 lekë) është rritur pas vitit 2006, ky ndryshim nuk është reflektuar në këtë analizë, pasi vlera e konsumit jetik është një vlerë referuese dhe jo reale.

Nëse shpenzimeve të gjyqtarëve u shtohet edhe kosto mesatare jetike sipas INSTAT në shumën 832,596 lekë për secilën deklaratë periodike/vjetore, atëherë numri total i deklaratave vjetore me pasuri të pajustificuara arrin në 232 deklarata nga 602 gjithsej, ose mbi 39% të totalit të deklaratave që iu nënshtruan kontrollit aritmetik dhe logjik.

Në mënyrë më të detajuar, numri i deklaratave që nuk justifikojnë pasurinë brenda vitit kalendarik sipas institucioneve përkatëse, nëse reflektohet vlera e konsumit mesatar vjetor sipas INSTAT prezantohet në Tabelën 19.

<sup>2</sup> Kostoja mesatare vjetore e jetesës, u llogarit duke shumëzuar numrin e muajve në funksion me koston mesatare mujore të jetesës për familje sipas INSTAT

**Tabela 19: Numri i deklaratave që nuk justifikojnë pasurinë, nëse reflektohet vlera e konsumit mesatar vjetor sipas INSTAT në kontrollit aritmetik dhe logjik.**

Institucioni	Numri i deklaratave	KAL me probl. INSTAT	Sa % e deklaratave rezultuan me probleme
Gjykata Administrative Durrës	44	16	36%
Gjykata Administrative e Apelit	181	62	34%
Gjykata Administrative Gjirokastrë	90	30	33%
Gjykata Administrative Korçë	37	23	62%
Gjykata Administrative Shkodër	28	5	18%
Gjykata Administrative Tiranë	182	82	45%
Gjykata Administrative Vlorë	40	14	35%
<b>Total</b>	<b>602</b>	<b>232</b>	<b>39%</b>



**Mbi 39% e deklaratave Periodike/Vjetore të gjyqtarëve të Gjykatave Administrative dështojnë gjatë kontrollit aritmetik dhe logjik, nëse shpenzimeve vjetore i shtohen kostot e konsumit jetik sipas INSTAT.**

Gjyqtarët përgjegjës për këtë rezultat janë pothuajse 98% e numrit të përgjithshëm të gjyqtarëve të Gjykatave Administrative, që do të thotë se nga 48 gjyqtarë, 47 prej tyre nuk e justifikojnë pasurinë të paktën një herë gjatë deklaramit periodik vjetor të pasurisë.

Si pasojë, vlera në total e pasurisë së pajustificuar rritet në 205,363,830 lekë, ose 29% e vlerës totale të pasurive neto të deklaruar nga 48 gjyqtarë deri me datë 31.12.2017.



**Rreth 29% e pasurisë neto të deklaruar nga 48 gjyqtarët e Gjykatave Administrative, rezulton e pajustificuar me burime financiare, nëse shpenzimeve i shtohen edhe kostot e konsumit jetik sipas INSTAT.**

## IV. DISKUTIME DHE REKOMANDIME

Analiza strukturore e të dhënave të deklaratave të pasurisë së 48 gjyqtarëve, të organizuar në gjashtë gjykata administrative të shkallës së parë dhe Gjykatës Administrative të Apelit tregojnë se mesatarisht çdo gjyqtar ka 9-fishuar pasurinë bruto nga deklarimi i parë deri në datë 31.12.2017. Pasuria mesatare në momentin fillestar është 2,030,090 lekë, ndërkohë që mesatarja e pasurisë së një gjyqtari në vitin e fundit të deklarimit (2017) është 17,592,932 lekë.

Ritmi i shpejtë i rritjes së pasurisë së 48 gjyqtarëve identifikon një numër trendesh, ku përfshihen transaksionet e dyshimta ose 'flamujt e kuq' gjatë periudhës 2004-2017:

- Mbajtja e likuiditeteve të larta cash, jashtë sistemit bankar
- Shuma të larta të huamarrjes nga persona të lidhur
- Detyrime të larta të pashlyera ndaj kompanive të ndërtimit
- Të ardhura të larta nga biznesi, shitja e pasurive të paluajtshme si dhe qiradhënia.
- Shpenzime të larta për këste kredie/ kredi të larta dhe jo të zakonshme

Përveç 'flamujve të kuq' të sipërpërmendur, të cilat u përfatuan nga analiza strukturore e të dhënave, nga kontrolli aritmetik dhe logjik i deklaratave të pasurisë së këtyre subjekteve të ligjit për deklarimin e pasurisë, rezulton se një numër shumë i lartë i gjyqtarësh nuk e justifikojnë dot pasurinë, të paktën gjatë një pike të caktuar në karrierën e tyre.

- 31 gjyqtarë ose 65% e totalit rezultojnë se kanë pasur të paktën në një vit të karrierës së tyre diferencë të pajustificuara midis pasurisë së krijuar dhe burimeve financiare të deklaruara.

Të dhënat e sipërcituara mbi 'flamujt e kuq' të identifikuar, tregojnë që origjina e një pjese të pasurisë së gjyqtarëve ngre dyshime se mund të ketë prejardhje nga burime të paligjshme, të cilat idealisht duhet ta shijnë Komisionin e Pavaruar të Kualifikimi, KPK- një ndër tre institucionet e vetingut, të ndërmarrë hetime të thelluara mbi pasurinë e tyre.

Gjithashtu, të dhënat e përfuara nga kontrolli aritmetik dhe logjik i deklaratave tregojnë se një numër i madh gjyqtarësh nuk arrin ta justifikojë pasurinë e tij/saj të paktën në një vit gjatë karrierës brenda sistemit gjyqësor, ç'ka është gjithashtu pikënisje tjetër për hetime të thelluara nga institucionet e vetingut.

Duke qenë se procesi i vetingut është në vazhdim dhe KPK është në përfundim të listës prioritare të



rivlerësimet, autorët e këtij raporti do të listonin rekomandimet e mëposhtme:

- Përdorimi i vlerësimeve të pavarura nga institucionet e vetingut mbi pasurinë e gjyqtarëve/prokurorëve.
- Përdorimi i të dhënave të këtij studimi nga ana e studiuesve, shoqërisë civile dhe gazetarëve për të vlerësuar dhe mbikëqyrur ecurinë e procesit të vetingut.
- Ndërmarrja e studimeve/monitorimeve të ngjashme nga organizatat e shoqërisë civile mbi trendet/strukturën e pasurisë së zyrtarëve publikë në Republikën e Shqipërisë.
- Kontroll i pavarur aritmetik-logjik i deklaratave të pasurisë së gjyqtarëve/prokurorëve që përfshihen në procesin e vetingut nga organizatat e shoqërisë civile dhe media.
- Rritja e kapaciteteve dhe e transparencës së ILDKPKI për të publikuar raporte periodike mbi trendet e pasurisë së zyrtarëve publikë.
- Rritja e transparencës nga Komisioni i Pavaruar i Kualifikimit në lidhje me vlerësimet dhe gjetjet e hetimit administrativ për pasurinë e gjyqtarëve/prokurorëve.

# Aneksi I

## Kodifikimi i kategorive dhe nënkategorive

Kodi_nënkategori	Nënkategoria	Kategoria
11	Pasuri të Paluajtshme	Asetet
12	Pasuri të Luajtshme	Asetet
13	Likuiditete në Cash	Asetet
14	Likuiditete në Bankë	Asetet
15	Pjesë në kapital/Aksione	Asetet
16	Person Fizik	Asetet
17	Sende me vlerë të veçantë	Asetet
18	Huadhënie	Asetet
19	Asete të tjera	Asetet
21	Kredi Bankare	Detyrimet
22	Huamarrje	Detyrimet
23	Detyrime ndaj shoqërive të ndërtimit	Detyrimet
24	Detyrime të tjera	Detyrimet
31	Paga nga funksioni	Të Ardhurat
32	Paga e familjarëve	Të Ardhurat
33	Shpërblime neto	Të Ardhurat
34	Të ardhura nga biznesi	Të Ardhurat
35	Të ardhura nga Qira	Të Ardhurat
36	Mësimdhënia	Të Ardhurat
37	Dhurata në Cash	Të Ardhurat
38	Të ardhura të tjera	Të Ardhurat
391	Të ardhura nga shitja e pasurive të paluajtshme	Të Ardhurat
392	Te ardhura nga shitja e pasurive te luajtshme	Të Ardhurat
393	Rivlerësimi i pasurive të paluajtshme	Të Ardhurat
411	Pagesë kësti kredie	Shpenzime
412	Pagesë kësti huaje	Shpenzime
413	Pagesë ndaj shoqërisë së ndërtimit	Shpenzime
42	Shpenzime shkollimi	Shpenzime
43	Shpenzime të tjera	Shpenzime

## Aneksi II

### Kursi i këmbimit të monedhave të huaja në Lekë, sipas kursit të këmbimit të Bankës së Shqipërisë

Periudha	Konvertimi në Lekë sipas Bankës së Shqipërisë				
	EUR	USD	GBP	CHF	CAD
31.12.2003	133.65	108.69	190.25	85.97	82.76
31.12.2004	126.74	92.64	178.69	81.87	76.92
31.12.2005	122.54	103.58	178.65	78.86	89.11
31.12.2006	123.85	94.14	184.65	77.17	81.13
31.12.2007	121.78	82.89	166.02	73.65	84.45
31.12.2008	123.8	87.91	127.66	82.97	72.22
31.12.2009	137.96	95.81	154.64	93.04	91.34
31.12.2010	138.77	104	161.46	110.98	104.29
31.12.2011	138.93	107.54	165.92	114.46	105.36
31.12.2012	139.59	105.85	171.18	115.65	106.37
31.12.2013	140.2	101.86	168.39	114.41	95.7
31.12.2014	140.14	115.23	179.48	116.52	99.55
31.12.2015	137.28	125.79	186.59	126.74	90.53
31.12.2016	135.23	128.17	157.56	126.05	95.09

## Aneksi III

Shpenzimet mesatare mujore dhe vjetore për Njësi Ekonomike Familjare,  
sipas Anketave të Buxhetit të Familjes publikuar nga INSTAT <sup>3</sup>

Viti	Shpenzime mesatare mujore	Shpenzime mesatare vjetore
2006	69,383	832,596
2014	69,442	833,304
2015	70,766	849,192
2016	73,160	877,920
2017	73,400	880,800

<sup>3</sup>Anketa e Buxhetit të Familjes, INSTAT 2017, [http://www.instat.gov.al/media/4783/abf\\_2017.pdf](http://www.instat.gov.al/media/4783/abf_2017.pdf)





**ANALIZË E SISTEMIT TË DEKLARIMIT DHE  
KONTROLLIT TË PASURISË SË GJYQTARËVE TË  
GJYKATAVE ADMINISTRATIVE  
NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË**

© Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Investigative, Shqipëri  
Tiranë, 2018